



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.17

Shkurt 2005

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 7.1. 2005 **PROJEKTLIGJE**

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për kompensimin e burgimit të padrejtë.

- Projektligji ka për qëllim rregullimin e të drejtës së personave të cilët janë deklaruar të pafajshëm, ose është pushuar çështja penale me vendim të formës së prerë të gjykatës apo prokurorit, si dhe të personave të mbajtur në burg tej kohës së caktuar me vendimin e dënimit, për të përfituar kompensimin.

Në projektligj përcaktohet masa dhe mënyra e përlogaritjes së kompensimit, procedurat për kërkimin dhe pagesën e kompensimit, rastet e përjashtimit nga e drejta për kompensimin etj.

2. Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillim Ekonomik Arab, për projektin e Rehabilitimit të Ujitjes (Faza III).

(Vijon në faqen 2)

Nga Punimet e Kuvendit

Nga Seanat Dëgjimore të Zhvilluara në Kuvendin e Shqipërisë

Janar – Shkurt 2005

**Raport
për veprimtarinë e
Komisionit të Shërbimit
Civil për vitin 2004**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 3.02.2005, zhvilloi seancën dëgjimore publike "Për Veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2004". Në seancën dëgjimore morën pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil. Media, edhe pse ishte një seancë dëgjimore mbi veprimtarinë e një institucioni të rëndësishëm siç është KSHC, nuk ishte e pranishme.

(Vijon në faqen 6)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

faqe 1-5

2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

faqe 1

4. Nga seancat dëgjimore të zhvilluara në Kuvendin e Shqipërisë janar-shkurt 2005

faqe 1,6-7

4. Nga punimet e Kuvendit janar 2005

faqe 8

5. Kalendari 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë

22 shkurt - 15 mars 2005

faqe 9-12

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.kehlliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Financave
www.min.fin.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
www.mtt.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 7.1.2005

- 1.** Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Strehimit.
- 2.** Për miratimin e zonave arkeologjike, brenda qendrave të banuara në Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë dhe Sarandë.
- 3.** Për miratimin e strategjisë për nxitjen e punësimit në administratën publike të studentëve të diplomuar jashtë vendit.
- 4.** Për miratimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar.
- 5.** Për transferimin në pronësi të Komunës Prezë, Tiranë, të mjediseve të ish-repartit ushtarak nr. 3800/1, batalioni "AKA" në Prezë, Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi, të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave. "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.
- 6.** Për transferimin në pronësi të bashkisë së Fierit të mjediseve të ish-spitalit ushtarak, Fier, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".
- 7.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.
- 8.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në Bashkinë e Krujës.
- 9.** Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në bashkinë e Maliqit.

10. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në bashkinë e Rrogozhinës.

11. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Margegaj.

12. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Cukalat.

13. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Fushë-Memaliaj.

14. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Grekon.

15. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Mollas.

16. Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore në komunën Vig – Muel.

17. Për dhënie fondi buxhetor Kryqit të Kuq Shqiptar, si ndihmë financiare për vendet e Azisë Juglindore, të cilat janë prekur nga Cunami, si dhe për forcimin e kapaciteteve të veta, për përthimin e situatave të emergjencave civile apo fatkeqësive natyrore.

18. Për miratimin e strukturës të Organikës dhe të pagave të punonjësve të Komitetit Shtetëror për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe të komisioneve vendore.

19. Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Tiranës.

20. Për propozim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të një Komisioneri, anëtar i Komisionit të letrave me Vlerë.

Të ndryshme

- Informacioni për masat e paralelizuar të Planit të Veprimit për Zbatimin e Prioritetëve të Partneritetit European.

II. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 13.1. 2005 **PROJEKTLIGJE**

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për Përgjegjësinë penale të personave juridikë.

- Marrëdhëniet juridike që parashikon të rregullojë projektligji janë kompleksë dhe përbëjnë një risi në të drejtën penale dhe traditën juridike shqiptare. Për herë të parë normohet ligjërisht edhe përgjegjësia penale e personave juridikë.

Në hartimin dhe përgatitjen e projektligjit, janë patur parasysh standartet dhe përvojat pranua europiane, të cilat janë të suksesshmenë përballjen me këtë fenomen.

2. Për përdorimin e mjeteve të video-mbikqyrjes së hapur, në vende publike dhe private, në funksion të sigurisë publike dhe të provës në procesin penal.

- Projektligji synon shmangien e problemeve të hasura gjatë zbatimit të ligjit procedural penal si dhe pengesave e vështirësive të dala nga praktikat e deritanishme mbi përdorimin e kamerave në vendet publike dhe private.

Projektligji përcakton kushtet dhe procedurat për lejimin dhe përdorimin e mjeteve të videombikqyrjes së hapur, organet përgjegjëse të ngarkuara për vlerësimin, lejimin dhe kontrollin e zbatimit, rregullat e përgjithëshme për zhvillimin e videombikqyrjes, duke përfshirë në to procedura dhe kompetenca lejuese dhe kontrolluese etj.

3. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8136, datë 31.7.1996 "Për shkollën e magistraturës të republikës së Shqipërisë".

Projektligji trajton probleme si:
- Realizimin nga shkolla edhe të veprimtarive të tjera të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore dhe të pro-

(Vijon në faqen 3)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 2)

fesioneve të tjera të lidhura me sistemin e drejtësisë.

- Rikonceptimin e organizimit dhe funksionimit të Bordit Drejtues duke u shndërruar në "Këshill Drejtues" në përputhje me nevojat e zhvillimit të shkollës.

- Përmirësimin e procedurave të emërimit të kandidatëve për magjistratë si gjyqtarë ose prokurorë etj.

4. Projektligji Për Muzetë:

- Ky projektligj plotëson një vakum ligjor dhe në të trajtohen probleme që kanë të bëjnë me llojet e muzeve, me mënyrën e krijimit të tyre, të drejtën e hapjes së rrugëve private, me fondin muzeor kombëtar, me statusin dhe kompetencat e "Komisionit shtetëror të Muzeve", me financimin e tyre, me detyrimin për regjistrim etj.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 13.1.2005

1. Për miratimin e "Planit të Pestë të masave për vitet 2005-2007".

2. Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 16.3.1999 "Për Inspektoriatin shtetëror të Kontrollit të naf-tës, gazit dhe Neuprodukteve (ISHKNG) të tyre", të ndryshuar.

3. Për konservimin e fabrikës së referimit në Uzinën e bakrit Rubik dhe për mbylljen e fabrikës së pasurimit të bakrit Mjedë, Shkodër.

4. Për lejimin e "ARMO" sh.a, Fier, të përdorë procedurën "prokurim i drejtëpërdrejtë", për auditimin e shoqërisë.

5. Për lejimin e KESH-sh.a –së, të bëjë rivlerësimin e pasurisë.

6. Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 31.10.2002 "Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtëshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Elbasan – Librazhd".

7. Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtëshme që preken nga ndërtimi i

ujësjellësit të ri të qytetit të Gjirokastrës.

8. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë e Malit të Zi, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

9. Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë të republikës së Moldavisë, për bashkëpunimin në fushën sanitaro-veterinare.

10. Për miratimin në parim të Marrëveshjes së Grantit Hollandez, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për planin e rregullimit të qytetit të Tiranës.

11. Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Sllovakisë dhe Republikës së Sllovenisë, për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e Arsimit të lartë, në kuadër të programit të shkëmbimit të Studimeve Universitare për Europën Qendrore (CEPUS II).

12. Për një ndryshim në vendimin nr 681, datë 22.10.2004, të Këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë "Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve".

13. Për transformimin në pronësi të bashkisë së Shijakut të mjediseve dhe të truallit funksional të pronës "ish-brigadë këmbësorie" në Shijak, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18. 7. 2003 të këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të

paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

14. Për lejimin e institucioneve buxhetore të përdorin procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

III. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 28.1. 2005
PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Për një ndryshim në ligjin nr.8778, datë 26.4.2001 "Për ratifikimin e konventës penale për kompensimin".

2. Për ratifikimin e konventës europiane "Për marrëdhëniet me fëmijët".

3. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor kombëtar të vepërimit, CARDS 2004.

4. Për një shtesë në ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

5. Për ratifikimin e instrumenteve që ndryshojnë Kushtetutën dhe Konventën e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, (Gjenevë, 1992).

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 28.1.2005

1. Për shpalljen e vitit 2005 "Viti i përkujtimit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut".

2. Për shpërndarjen në koeficient kreditorëve të shoqërisë "Vefa Holding", sh.p.k, në administrim, të vlerave financiare, të realizuara nga shitja e aseteve.

3. Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, të afateve dhe procedurave për të përfituar

(Vijon në faqen 4)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 3)

strehim nga programet e bane-save sociale me qira.

4. Për përcaktimin e kritereve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare.

5. Për kalimin e përgjegjësive së administrimit të mjediseve të repartit infektiv të spitalit të Elbasanit, nga Ministria e Shëndetësisë të ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

6. Për përcaktimin e marzheve të fabrikimit dhe të traitimit të barnave.

7. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të bëra për kurimin jashtë shtetit të Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror, zotit Kujtim Hysenaj.

8. Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore.

9. Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore.

10. Për fianancimin e Konferencës Ndërkombëtare të Tokës, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-18 mars 2005.

11. Për miratimin e ndryshimit të marrëveshjes së themelimit të bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

12. Për miratimin në parim të marrëveshjes shtesë të huasë dhe të projektit të lidhur me marrëveshjen e kredisë të datës 24 korrik 1999, të ndryshuar me marrëveshjen shtesë të kredisë dhe të projektit të datës 5 tetor 2002, ndërmjet republikës së Shqipërisë dhe kreditanstalt fur Eiederban (KFĒ), Frankfurt am Main, për furnizimin me energji elektrike në Jug të Shqipërisë.

13. Për disa shtesa në vendimin nr.90, datë 21.3.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pasurive të

paluajtëshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Lezhë-balldre, pjesë e seksionit Lezhë – Shkodër".

14. Për lejimin e Ministrisë së rregullimit të territorit dhe të Turizmit, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për të kryer shërbimin transmetim spoti televiziv, për sensibilizimin e shtetasve për legalizimin e zonave informale.

15. Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të beratit.

16. Për ngritjen e Bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Pogradecit.

17. Për ngritjen e Bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Sarandës.

18. Për ngritjen e Bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Gjirokastrës.

19. Për lejimin e drejtorisë së Përgjithëshme të rezervave të shtetit të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për blerjen e disa mallrave, rezerve shtetërore, për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet e dëborës.

20. Për dhënie fondi shtesë disa njësive të qeverisjes vendore për përballimin e emergjencave të krijuara për shkak të reshjeve të dëborës.

IV. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 4. 2. 2005 PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerëve dhe nënoficerëve lundruar të nëndetseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension". - Ky projektligj ka qëllim të rregullojë trajtimin financiar të efektivave oficerëe nënoficerë nëpunës dhe polumbarë në pension të Forcave Detare, të cilat kanë

kryer detyra me rrezikshmëri të lartë për shëndetin dhe jetën.

2. "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin që ndryshon nenet 1 (A) dhe 14 (1), (3) (B), të marrëveshjes europiane të 30 shtatorit 1957, për transportin ndërkombëtar rrugor, të mallrave të rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë, më 28 tetor 1993". - Aderimi i Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), është miratuar me ligjin nr 9272, datë 16.9.2004.

Qëllimi i protokollit është amendimi i dy neneve të marrëveshjes: - Zëvendësimin e termit "automjet" me "mjet"

- Të drejtën e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, të propozojë amendamente për shtojcat e Marrëveshjes.

- Zgjatjen e afatit të hyrjes në fuqi të një amendamenti, e cila mund të jetë edhe më shumë se tre muaj.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 28.1.2005

1. Për rritjen e masës së trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake dhe të pilotëve fluturues, në pension.

2. Për miratimin në parim të disa ndryshimeve në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian, për menaxhimin e krizës në Bosnje Hercegovinë (Operacioni "ALTHEA").

3. Për transferimin në pronësi të bashkisë së Delvinës të mjediseve të ish-brigadës së këmbësorisë, në Rusan, Delvinë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të këshillit të Min-

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 4)

istrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme, shtetërore, të cilat i kalojnë nëpërgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

4. Për miratimin e protokollit të bisedimeve për bashkëpunimin financiar dhe teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për vitin 2004, dhe të amendamenteve të tij.

5. Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një mjedisi të "Alba Film Studio", Tiranë, shoqërisë së "Orafilm", shpk, Tiranë.

6. Për dhënie fondi disa njësave të qeverisjes vendore për përbalimin e emergjencave nga reshjet e dëborës.

7. Për një shtesë fondi Ministrisë së Pushtetit vendor dhe të Decentralizimit për mbulimin e shpenzimeve për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore.

V. Mbledhje e Këshillit të Ministrave e datës 11. 2. 2005

PROJEKTLIGJE

(Vendime për propozime projektligjesh)

1. Projektligji "Për gjuhën shqipe" - Projektligji do të plotësojë një boshllëk ligjor të derisotëm dhe do të shërbejë për të mbrojtur ligjërisht gjuhën shqipe standarte. Sipas projektligjit, të gjitha institucionet në territorin e republikës së Shqipërisë do të jenë të detyruara të zbatojnë normën gjuhësore të shqipes standarte.

2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr .8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera nën tokë".

Qëllimi i këtij projektligji është:
- Indeksi ose rritja e masës së trajtimit për personat që përfillojnë nga ligji nr. 8685 (i sipërpër-

mendur), nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sa herë dhe në atë masë që rriten apo indeksohen pensionet e pleqërisë.

- Johja e periudhës së trajtimit të veçantë (duke filluar dt. 16.12.2000 e në vazhdim), periudhë sigurimi për efekt pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar, nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 11.2.2005

1. Për miratimin e strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, viktima të trafikimit, dhe për një shtesë në vendimin nr. 8, datë 5.1.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore".

2. Për krijimin e Entit të Turizmit

3. Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithëshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës "BOO", të një sipërfaqeje përreth Fabrikës së Çimentos Fushë – Krujë.

5. Për regjistrimin e pronave të paluajtëshme të Republikës së Shqipërisë të Truallit prej 183 mijë m² në Gjirin e Vlorës, dhënë me koncesion shoqërisë "La Petrolifera italo-albanese".

6. Për krijimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura.

7. Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.405, datë 8.1.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Për miratimin në parim të marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për fi-

nancimin e projektit për spitalin e përgjithshëm të Kavajës.

9. Për miratimin në parim të marrëveshjes detare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së republikës së Turqisë.

10. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për zbatimin e projektit "Menaxhim i integruar i ekosistemit të Liqenit të Shkodrës".

11. Për miratimin në parim të marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për përgatitjen e projektit "Menaxhim i integruar i ekosistemit të Liqenit të Shkodrës".

12. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për bashkinë e Elbasanit, për mbulimin e shpenzimeve administrative të qendrës sociale "Balashe".

13. Për një shtesë në vendimin nr. 310, datë 14.5.2004 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e personaliteteve të larta shtetërore, të cilat do të ruhen nga Garda e republikës së Shqipërisë, pas lirimit nga funksioni, dhe për një ndryshim në vendimin nr.422, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, "Për ruajtjen dhe shoqërimin e personaliteteve të larta shtetërore".

14. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për prodhimin e armatimit luftarak.

15. Për lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për prodhimin municioneve luftarake.

16. Për lirim dhe emërim në detyrë.

NGA PUNIMET E KUVENIT PËR PERIUDHËN Janar-Shkut 2005

(Vijon nga faqja 1)

Komisioni dëgjoi raportimin e bërë nga kryetari i KSHC

z.Roland Përmeti, i cili bëri një ekspozitë të zgjeruar të punës së këtij institucioni të pavarur në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij, ku, ndër të tjera përfshiheshin çështjet: shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave; rritja e nivelit të mbikqyrjes dhe menaxhimit të shërbimit civil; bashkërendimi i punës si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera; ecuria e reformave në shërbimin civil në kuadër të procesit të integritetit në BE; bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare; si dhe prioritetet për vitin 2005.

Pas raportimit, deputetët i drejtuan pyetje anëtarëve të KSHC dhe, më pas diskutuan rreth raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni. Deputetët, në përgjithësi, vlerësuan punën e bërë nga ky institucion dhe arritjet e tij krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, ata mbështetën shqetësimin kryesor të anëtarëve të KSHC lidhur me shkallën e zbatimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil" si dhe domosdoshmërinë e amendimit të këtij ligji me qëllim përmirësimin e punës në procesin e reformimit të administratës publike.

Në përfundim të diskutimeve të seancës dëgjimore, në përputhje me nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni hartoi dhe miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e punës së këtij institucioni, e cila më pas u depozitua sipas procedurës për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare.

Disa konkluzione dhe rekomandime nga raporti i Komisionit të Shërbimit Civil.

KSHC është strukturë e rëndësishme institucionale dhe ligjore, i cili plotëson skemën e zbatimit të ligjit. KSHC është një institucion i pavarur nga institucionet e tjera e në radhë të parë nga Këshilli i Ministrave. Anëtarët e KSHC-së janë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KSHC ka disatribute të rëndësishme ligjore e juridikionale, të cilat e shndërrojnë atë në një arbitër administrativ për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil dhe një mbikqyrës i zbatimit të ligjit në fushën e administrimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që hyjnë në sferën e veprimit të ligjit për statusin e nëpunësit civil.

Veprimtaria e KSHC-së gjatë vitit 2004, sipas raportit, ka ndikuar në fuqizimin e qëndrueshmërisë së shërbimit civil, në rritjen e performancës

së nëpunësve civilë dhe në thellimin e reformës në administratën publike shqiptare.

Gjatë vitit 2004 KSHC ka zhvilluar 69 mbledhje si institucion kolegjal, rreth 6 mbledhje në muaj, të cilat janë zhvilluar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe "Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të KSHC-së" të miratuar me vendimin nr.47, datë 20.06.2002 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këto mbledhje janë zhvilluar seanca dëgjimore për 287 ankesa dhe janë marrë vendime për 268 prej tyre. Krahasuar me vitin 2003 ka një rritje prej 56 ankesash paraqitur në KSHC për shqyrtim.

Nga 275 çështje të shqyrtuara, 39.4 % e numrit të përgjithshëm të ankesave, kanë përfunduar në favor të nëpunësit civil ankues, ndërsa 27 %, janë rrëzuar si të pabazuara në ligj dhe 31.3 % e çështjeve të shqyrtuara kanë përfunduar me pushim shqyrtimi.

Vendimet e KSHC-së kanë qenë të bazuara në ligj. Këtë fakt e tregojnë edhe lënia e në fuqi e 39 vendimeve nga 43 të ankimtuara pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Niveli i zbatimit të vendimeve të KSHC-së nuk ka qenë i kënaqshëm. Nga 110 vendime të dhëna në favor të ankuesve janë zbatuar direkt nga organet administrative që u janë kundërtuar vetëm 39 prej tyre ose 28 % e tyre. Akoma më i pa pranueshëm është mosbatimi nga drejtues të ndryshëm i 38 vendimeve, të cilat janë shqyrtuar dhe janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, e për rrjedhojë janë kthyer në tituj ekzekutivë. Zyra e Përmbarimit, si organ kompetent shtetëror duhet të luajë rolin e saj ligjor, për ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre vendimeve.

Për një funksionim me efikasitet të KSHC-së si një institucion relativisht i ri, kërkohet mbështetje politike, institucionale, por edhe financiare.

Në njësitë e administratës publike vendore ka një shkallë relativisht të ulët njohje të ligjit për shërbimin civil. Shkeljet e ligjit për shërbimin civil konstatohen sidoms në pranimin e nëpunësve civilë, duke aplikuar emërime nga titullarët e institucioneve, pa iu nënshtruar procedurave ligjore për rekrutimin, ç'ka është një shkelje e hapur e ligjit për pranimin në shërbimin civil. Shfaqje të moszbatimit të ligjit janë ndeshur edhe në lëvizjet paralele; në ngritjet në detyrë dhe në procesin e konfirmimit të nëpunësve civilë në fund të periudhës së provës.

(Vijon në faqen 7)

NGA PUNIMET E KUVENIT PËR PERIUDHËN Janar-Shkut 2005

(Vijon nga faqja 6)

Në praktikë janë evidentuar edhe vështirësi në zbatimin e skemës së shërbimit civil që kanë ardhur për shkaqe objektive si mungesa e buxhetit, largimi i specialistëve të arsimuar etj.

Në administratën qendrore konstatohen përmirësime të dukshme në disa drejtime si: në procesin e emërimit janë përmirësuar procedurat e konkurimit; është konsoliduar procesi i vlerësimit të arritjeve të punës vjetore të nëpunësve civilë me qëllim forcimin e performancës dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre.

Rekomandime

1. Për të rritur shkallën e zbatimit të ligjit "Statusi i Nëpunësit Civil" është e nevojshme që KSHC në ushtrimin e funksionit të saj mbikqyrës për administrimin e shërbimit civil të institucioneve që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji, të përdorë mjete juridike më efektive e detyruese ndaj institucionit ku konstaton parregullsi, pasi mjete ligjor i 'paralajmërimit' ka rezultuar pasiv dhe nuk i përgjegjet dinamikës së veprimitarisë së administratës publike. Për kwtw qvllim duhet të bëhet rregullimi në nenin 8 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", ku të parashikohet e drejta e KSHC-së për të ndryshuar ose shfuqizuar aktet administrative të institucionit përkatës të administratës publike kur ato nuk janë në përputhje me kërkesat e ligjit.
2. Për zbatimin në kohë të vendimeve të KSHC-së në lidhje me ankesat e nëpunësve civilë është e nevojshme parashikimi shprehimisht në ligj që ekzekutimi i aktit administrativ duhet të pezullohet kur nëpunësi civil paraqet ankim ndaj këtij akti në KSHC dhe ky plotësim të bëhet në nenin 8, pika 2, të ligjit të lartpërmendur.
3. Nga praktika e deritanishme shtrohet si kërkesë vendosja e masave detyruese ndaj drejtuesve të institucioneve të cilët nuk zbatojnë vullnetarisht vendimet e KSHC-së.
Së pari, duhet të plotësohet në nenin 8, pika 3, e ligjit të lartpërmendur se vendimet e KSHC-së të cilat kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar janë tituj ekzekutivë.
Së dyti, parashikimi i sanksioneve apo peanaliteteve për drejtuesit e administratës publike qendrore dhe vendore të cilat nuk zbatojnë vendimet e KSHC-së.

4. Gjithashtu ulja e afateve të ankimit në KSHC dhe ndaj vendimeve të KSHC-së duhet të jetë 15 ditë nga komunikimi i tyre dhe jo 30 ditë pune siç është aktualisht. Ky ndryshim i afateve do të rrisë shpejtësinë dhe efektivitetin e vetë vendimeve të KSHC-së në zbatimin e ligjit.
5. Një drejtim tjetër ku duhet të ndryshohet ligji është dhe zgjerimi i sferës së shërbimit civil dhe me institucione të tjera e konkretisht, në institucionet e administratës qendrore të përfshihen dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave; në varësi të Ministrive; degët e ministrive në rrethe si dhe administratën e Prefektit, ndërsa në institucionet e administratës vendore të përfshihet edhe administrata e komunave.
6. Praktika e deritanishme flet se procesi pranimit në shërbimin civil duhet të përmirësohet.
Së pari, duke unifikuar konkurimet si kohë që mund të jetë 1 ose 2 herë në vit sipas nevojave që shtron plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil dhe jo një konkurim për një vend të lirë pune;
Së dyti, për të evituar problemet e shfaqura nga formalizmi dhe subjektivizmi në procesin e pranimit në shërbimin civil, me qëllim që të kryhet një përzgjedhje e kandidatëve bazuar në meritat reale, kemi mendimin, - sipas raportit, - se konkurimet nuk duhet të kryhen nga vetë institucionet por nga një agjenci e veçantë publike me detyrë konkrete zgjedhjen e më të mirëve në tregun e punës nëpërmjet testeve bazuar në metoda bashkëkohore. Fituesi i konkurimit do të jetë fituesi i vendit të punës i shpallur për konkurim, duke hequr procesin e përzgjedhjes me 3 kandidatët më të mirë.
Së treti, ngritja në detyrë e nëpunësve civilë si shprehje e zhvillimit të karrierës duhet të bëhet me konkurim të posaçëm vetëm me anë të dokumenteve. Gjithashtu ngritja në detyrë nuk mund të bëhet më tepër se një klasë, bazuar në përcaktimin e klasave që e jep neni 11 i ligjit dhe me kusht që nëpunësi civil të ketë punuar për një periudhë jo më pak se 3 vjet në pozicionin e mëparshëm.

NGA PUNIMET E KUVENTIT PËR PERIUDHËN Janar-Shkut 2005

Më datë 10 janar 2005 Kuvendi, me nismë të më shumë se 1/5 së deputetëve, u mbledh në një sesion të jashtëzakonshëm. Thirrja e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm mori shkas nga Protokollin i nënshkrimit i datës 30 dhjetor 2004 midis dy forcave të mëdha politike, PS – PD dhe në prani të Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Pavël Vacek. Protokollin parashikon që palët PS – PD bien dakord të shfuqizojnë ligjin aktual mbi ndarjen e zonave zgjedhore dhe të përgatisin e të miratojnë një ligj të ri që do të përcaktojë 100 zona zgjedhore me një numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish dhe me një shmangje prej jo më shumë se 10 për qind nga numri mesatar i zgjedhësve në një zonë zgjedhore. Në lidhje me këtë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të ndihmojë në ngritjen e një grupi pune ekspertësh për ndarjen e zonave zgjedhore me përfaqësues të PS-së dhe PD-së, të cilët do të hartojnë një ligj të ri, në prani edhe të një eksperti ndërkombëtar në këtë fushë. Po sipas protokollit të nënshkruar, grupi i ekspertëve, në ndarjen e zonave zgjedhore, do të mbështetet tek një kombinim i përshtatshëm i kriterëve, ashtu si renditen në Kodin e Praktikave të Mira të Komisionit të Venecias të Këshillit të Europës, çka do të thotë tek: popullsia, numri i banorëve me shtetësi shqiptare, numri i zgjedhësve të regjistruar dhe mundësisht, numri i zgjedhësve që kanë votuar, me qëllim që të përcaktohen shifrat më të përafërta të mundshme të numrit të vërtetë të zgjedhësve në zonat elektorale. Në referim të këtij Protokollin, sesioni i jashtëzakonshëm parashikonte si rend dite shqyrtimin e amendamenteve të Kodit Zgjedhor (mbetur pezull nga sesioni i mëparshëm për shkak të mosarritjes së kompromisit PS – PD) si dhe ngritjen e grupit të punës së ekspertëve për projektligjin e ndarjes së zonave zgjedhore.

Për shqyrtimin e *projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"* Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore, i cili në punën e tij u mbështet në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias.

Projektligji ka për qëllim realizimin e zgjedhjeve të ndershme, të lira, të drejta dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të vitit 2005. Ai përpiqet të eliminojë mangësitë e ligjit ekzistues, të konstatuara gjatë proceseve zgjedhore të vitit 2001 dhe 2003, duke përmirësuar përmbajtjen e shumë neneve të ligjit ekzistues.

Një ndër ndryshimet më të rëndësishme që propozohen t'i bëhen ligjit ekzistues ka të bëjë me numërimin e përqëndruar të votave në vende publike, i cili ndikon në rritjen e transparencës gjatë procesit të numërimit të votave dhe rrit përgjegjësinë e anëtarëve të komisioneve zgjedhore dhe të anëtarëve të grupeve të numërimit në administrimin e këtij procesi. Projektligji synon të rrisë kompetencat e organeve të qeverisjes vendore në administrimin e procesit zgjedhor dhe të pakësojë rolin e partive politike në këtë proces.

Ndryshimet e tjera që propozohen t'i bëhen ligjit ekzistues kanë të bëjnë me:

- krijimin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e dy niveleve më të ulëta të komisioneve të administratës zgjedhore;
- përmirësimin në organizimin dhe funksionimin e KQZ-së;
- përmirësimin e paketës për listën e zgjedhësve;
- ankimin administrativ dhe gjyqësor ndaj vendimeve të administratës zgjedhore; financimin e fushatës zgjedhore dhe detyrimin për deklarim të financimeve me burim jo-shtetëror;
- caktimin e vëzhguesve, të koalicioneve zgjedhore, zgjidhjen e çështjeve për personat që nuk mund të votojnë vetë, për votimin në institucionet e posaçme etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore, në Komisionin për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe në seancë plenare deputetët u ndalën veçanërisht në amendamentet e propozuara nga grupet parlamentare të LZHK-së dhe LSI-së.

Në këto amendamente synohet të sigurohet një përfaqësim i plotë i të gjitha forcave politike në procesin zgjedhor, duke e bërë këtë proces demokratik dhe të pranueshëm nga të gjitha palët. Amenduesit kundërshtuan formulën e krijimit të Komisioneve të Zonave Zgjedhore dhe të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe shprehën mendimin se përfaqësimi i forcave politike në këto komisione bipolarizohet nga dy partitë e mëdha, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, gjë që bie në kundërshtim me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Në këtë mënyrë, theksuan ata, shmanget përfaqësimi në këto komisione i forcave të tjera të rëndësishme politike. Propozimi i amenduesve ishte që të gjitha partitë që kanë grupe parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë të kenë përfaqësues në Komisionet e Zonave Zgjedhore dhe në grupet e numërimit. Gjithashtu, në amendamentet e tyre propozohet të rritet roli i anëtarëve të komisioneve zonale dhe të vëzhguesve të subjekteve të ndryshme politike në administrimin e procesit të votimit. Gjatë diskutimit përfaqësuesit e grupeve parlamentare të LZHK-së dhe LSI-së akuzuan dy forcat kryesore politike për kompromentim të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. Në përfundim të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

Më pas, punimet e Kuvendit u fokusuan në pikën e dytë të rendit të ditës, që ishte ngritja e grupit të punës së ekspertëve teknikë, i cili do të sigurojë dhe do të japë asistencën teknike për hartimin e projektligjit për ndarjen e zonave zgjedhore, sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Përbërja e grupit të ekspertëve mbështetet në Protokollin e nënshkruar më datë 30 dhjetor 2004 midis dy forcave politike PS-PD. Kuvendi ngarkoi grupin e ekspertëve që të përfundojë punën për hartimin e projektligjit për ndarjen e zonave zgjedhore, duke patur parasysh kriteret që duhen përdorur siç janë popullsia, numri i zgjedhësve të regjistruar dhe numri i zgjedhësve që kanë votuar në votimet e fundit.

KALENDAR I

3 JAVOR (22 shkurt-15 mars 2005) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E hënë datë 21.2.2005 – Ora 17.00

- Seancë plenare

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit¹
2. Pyetje dhe Interpelanca

Data 22 shkurt 2005 deri 4 mars 2005
Veprimtari në komisione

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096 date 21.3.1993 “Për kinematografinë”

Komisioni per Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Relator: Vath Koreshi, Bardhyl Londo

- Projektligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
Vijon diskutimi nen për nen (Mbledhje e përbashkët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë”

Relatorë: Ylli Bufi, Marjeta Pronjari

- Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9049 datë 1.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nën-punësve publikë” – *iniciative e deputetit Neritan Alibali*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Sotir Kokeri, Sali Shehu

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Relator: Flamur Hoxha

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8607 datë 27.4.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Relator: Dashmir Shehi

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtjan për Zhvillimin

Ekonomik ARAB, për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza II)”

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Relator në Komisioni për Ekonominë dhe Financat Hasan Hoxha

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për ripranimin e personave dhe te protokollit të saj”

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Sigurinë Kombëtare

- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuar në Kosovë në emër të institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes në Kosovë për shmangien e tatimeve të dysihta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal”

Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Relator në Komisioni për Ekonominë dhe Financat Dritan Prifti

- Projektligji “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”
Jep mendimin për harmonizimin me legjislacionit të Bashkimit European Komisioni për Integrimin European

- Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9087 datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Relator: Nezir Selimi
(Vijon në faqen 10)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 9)

- Projektligji “Akti i lirisë së shtypit”
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Relator: Preç Zogaj
- Shqyrtimi i propozimeve të Këshillit të Ministrave për një anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Shqyrtimi i propozimit për një anëtar të Komisionit të Letrave me Vlerë
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- Projektligji “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”
Komisioni për Sigurinë Kombëtare
Relator: Shaban Memia
Jep mendim për ndikim në buxhetin e shtetit Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- Projektligji “Për pezullimin e procedurave të privatizimeve deri në legjislaturën vijuese të Kuvendit”
Paraqitur nga deputetët Neritan Alibali dhe Aleksandër Garuli.
Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat
- P/vendim “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e tokës”.
Paraqitur nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.
Komision përgjegjës: Komisioni Ekonomisë dhe Financës
Jep mendim: Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
- Shqyrtimi i Dekreteve të Presidentit për dhënie pëlqimi për emërimin e dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë.
Komisioni përgjegjës: Komisioni Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.
- Seancë dëgjimore publike për Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Senacë dëgjimore publike për informimin nga Prokurori i Përgjithshëm
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
- Seancë dëgjimore publike për Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE)
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese Tregtinë dhe Mjedisin

E enjte, datë 24.2.2004 - Ora 10.00

- Seancë plenare

1. Diskutim për çështje që nuk janë në rendin e ditës (*deri në 60 minuta*)
2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

– Projektligji “Për ratifikimin e marrveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrueshëm të Liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij Ujëmbledhës”

Relator: Niko Faber

– Projektligji “Për ratifikimin e marrveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjelltë në çështjet juridike”

Relator: Vladimir Malo

– Projektligji “Për ratifikimin e marrveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Kuvajtjan për Zhvillimin Ekonomik ARAB, për projektin e rehabilitimit të ujitjes (Faza II)”

Relator: Hasan Hoxha

– Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9062 datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”

Relator: Spartak Braho

– Projektligji “Për kontrollin e figurës së personit zyrtar të zgjedhur apo të emëruar në organe të rëndësishme të shtetit”

Relator: Makhbule Çeço, Pjeter Arbnori

– Zgjedhja e një anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil

– Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Letrave me Vlerë.

– Shqyrtimi i Dekreteve të Presidentit për dhënie pëlqimi për emërimin e dy anëtarëve të Gjykatës së Lartë.
3. Ora 12.00 votimi i projektligjeve në parim, shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi.

Data 7 mars 2005 deri 15 mars 2005
Veprimtari në komisione

- Projektligji “Për konfliktin e interesave”

(Vijon në faqen 11)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 10)

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Albert Çaçi

- Projektligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

Diskutimi nen për nen (Mbledhje e përbashket e Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8749 datë 1.3.2001 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik”

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Relator: Fatmir Xhindi

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8685 datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera dhe nëntokë”

Komisioni për Punën,

Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Relator: Fatbardha Shabani

- Projektligji “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,

Tregtinë dhe Mjedisin

Relator: Zydi Pepa

- Projektligji “Për efikasitetin e energjisë”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese,

Tregtinë dhe Mjedisin

Relator: Dilaver Qesja

- Projektligji “Për sportin”

Komisioni për Edukimin dhe

Mjetet e Informit Publik

Relator: Agron Tato

- Projektligji “Për borxhin shtetëror dhe garancitë e huave shtetërore të Republikës së Shqipërisë”

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Relator: Ejup Tabaku

Seancë dëgjimore publike për raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

E hënë datë 28.2.2005 - Ora 17.00 - Seancë plenare

1. Pyetje dhe Interpelanca

2. Informim i Prokurorit të Përgjithshëm

E enjte, datë 3.3.2005 - Ora 10.00

– Seancë plenare

1. Diskutim për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta)

2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

– Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për ripranimin e personave dhe te protokollit të saj”

– Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuar në Kosovë në emër të institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes në Kosovë për shmangien e tatimeve të dysihta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal”

Relator: Dritan Prifti

– Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”

Relator: Flamur Hoxha

– Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096 datë 21.3.1993 “Për kinematografinë”

Relator: Vath Koreshi, Bardhyl Londo

– Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8607 datë 27.4.2000 “Statusi i Deshmorit të Atdheut”, i ndryshuar”

Relator: Dashamir Shehi

3. Shqyrtimi i kërkesës së një grupi deputetësh për ngritjen e komisionit hetimor për hetimin e praktikave të privatizimit.

4. Ora 12.00 votimi i projektligjeve në parim, shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi.

E Hënë Datë 7.3.2005 - Ora 17.00

- Seancë plenare

1. Pyetje dhe Interpelanca

2. Raporti i Avokatit të Popullit dhe votimi i projekt-rezolutes për vlerësimin e punës së këtij institucioni.

E enjte, datë 10.3.2005 - Ora 10.00 – Seancë plenare

1. Diskutim për çështje që nuk janë në rendin e ditës (deri në 60 minuta)

2. Diskutimi në parim i projektligjeve:

(Vijon në faqen 12)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 11)

– Projektligji “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”
Relator: Ylli Bufi, Marjeta Pronjari

– Projektligji “Akti i lirisë së shtypit”
Relator: Preç Zogaj

– Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9087 datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”

Relator: Nezir Selimi

5. Ora 13.00 votimi i projektligjeve në parim, shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi.

E Hënë Datë 14.3.2005 - Ora 17.00

- Seancë plenare

1. Pyetje dhe Interpelanca
2. Raporti i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe votimi i projektrezolutes për vlerësimin e punës së ketij institucioni.

KOHA PËR ÇËSHTJET E PARASHIKUARA PËR SHQYRTIM NË KALENDARIN E PUNIMEVE TË KUVENDIT

Nismëtari i projektligjit	15 minuta
Paraqitja e raportit të komisionit	-
Relatori	10 minuta
Çdo deputet për diskutimin në parim	10 minuta
Çdo deputet për diskutimin nen për nen	5 minuta

SHQYRTIMI RAPORTEVE TË INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË KUVEND

Paraqitja e raportit	60 minuta
Paraqitja e projektrezultës së Komisionit	-

Në seancën plenare për shqyrtimin e raportit mund të mbahet debat në rast se kërkohet me shkrim një gje e tillë nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë. Koha e debatit përcaktohet paraprakisht nga Konferenca e Kryetarëve.

KUJTESË

1. Amendamentet, si rregull, paraqiten në komisionin përgjegjës. Amendamentet mund të paraqiten në seancë plenare me kusht që të jenë rregjistruar 24 orë para kohës së fillimit të shqyrtimit të projektligjit.
2. Autori i amendamentit të rrëzuar në komisionin përgjegjës ka të drejtë ta paraqesë atë në seancë plenare për jo më shumë se 7 minuta.

3. Çdo deputet që dëshiron të diskutojë në seancë plenare duhet të jetë rregjistruar në sekretari para fillimit të seancës plenare.

RAPORTET E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR SEANCËN PLENARE

Raportet e komisioneve të përhershme për në seancë plenare duhet të përmbajnë:

1. Nevojën e ndërhyrjes normative në fushën e caktuar të marrëdhënies shoqërore.
2. Analizën e përputhshmërisë së projektligjit me Kushtetutën.
3. Raportin mes parimeve dhe formulimeve të sanksionuara në projektligj me atë të legjislacionit ekzistues.
4. Efektet sociale, ekonomike dhe juridike të projektligjit. Vend i veçantë duhet t'i jepet çështjes së efekteve financiare që sjell projektligji dhe nëse ka rritje të shpenzimeve të buxhetit të shtetit si do të përballohen ato.
5. Harmonizimin e projektligjit me legjislacionin në fuqi. Komisioni i Integritetit Europian paraqet analizën për harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Europian.
6. Për marrveshjet ndërkombëtare duhet të tregohet nevojshmëria e ratifikimit të marrëveshjes me ligj, vetzbatueshmëria e marrëveshjes dhe, nëse ajo s'është e tillë, kuadrin e akteve ligjore që duhet të preken me qëllim që marrëveshja të vihet në zbatim.
7. Konsiderat për elementet e gjuhës normative të përdorur në drejtim të formulimit të projektligjit, ndertimit të tij, formulimit të neneve, referencat, delegimin për nxjerrjen e akteve nënligjore, dispozitat tranzitore dhe e hyjes në fuqi.

(Shënim)

¹ Në këtë kalendar 3 javor të punimeve të Kuvendit, nuk është përfshirë projektligji “Për caktimin e zonave zgjedhore”. Ky projektligj, në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor do të futet në kalendarin e punimeve për këtë periudhë me prioritetet sapo të depozitohet iniciativa ligjvënese.

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org